

## **RREGULLORE PËR KONTROLLIN E CILËSISË**

### **NË KRYERJEN E ANGAZHIMEVE TË AUDITIMIT, RISHIKIMIT, DHËNIES SË SIGURISË DHE TË MISIONEVEVE TË TJERA NGA EKSPERTET KONTABËL TË REGJISTRUAR**

#### **Te pergjithshme**

Duke mbajtur parasysh që Eksperti Kontabël i Regjistruar është një profesionist i pavarur, i cili e ushtron veprimtarinë profesionale ne perputhje me kerkesat e ligjit 10091 dt. 05.03.2009 ‘Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të EKR dhe KM’;

Duke vleresuar rolin dhe kontributin e tij në mbrojtje të interesit publik, përmes zbatimit të standardeve teknike e profesionale cilësore dhe respektimit të kërkesave që burojnë nga kodi i etikës;

Duke u mbështetur në detyrimet ligjore dhe statutore për mbikqyrjen dhe monitorimin nga Instituti të cilësisë së performancës së angazhimeve të anëtarëve të tij përmes zbatimit të rregullave dhe standardeve profesionale dhe të etikës gjatë kryerjes së angazhimeve profesionale;

Në zbatim të nenit 38 të ligjit 10091 dt. 05.03.2009 dhe të nenit 15.2.4 të statutit të IEKAs, Këshilli Drejtues i propozon për miratim Bordit të Mbikëqyrjes Publike këto rregullore të kontrollit të cilësisë

#### **Neni 1. Qellimi**

Në zbatim të nenit 38 te ligjit 10091 date 05.03.2010, per te garantuar cilësinë e angazhimeve profesionale të anëtarëve të IEKA, ngrihet dhe funksionon sistemi i dhënies së sigurisë për cilësinë, i cili përfshin: kontrollin e cilësisë në nivel angazhimi individual, kontrollin e cilësisë, që organizohet brenda shoqërisë së auditimit / personit fizik; dhe kontrollin e cilësisë, që organizohet nga IEKA, përmes një komiteti të pavarur, i cili është subjekt i mbikëqyrjes nga BMP-ja.

Kontrolli i cilësisë në nivel angazhimi individual garantohet nga zbatimi prej audituesve ose ortakëve të angazhimit të të gjithë kërkesave të pershkruara në të gjithë standardet ndërkombëtare të auditimit, të cilat janë të zbatueshëm në kontekstin e angazhimit individual.

Kontrolli i cilësisë brenda firmës/kabinetit të auditimit, garantohet permes vendosjes së rregullave të brendëshme të rishikimit për qëllime të kontrollit të cilësisë së angazhimeve, te cilat bazohen në SNKC1 dhe në udhëzimet përkatëse të përpunuara nga IEKA.

Kontrolli i Cilësisë që organizohet nga IEKA është një procedurë e shqyrtimit nga Këshilli Drejtues i saj, në lidhje me veprimtarinë profesionale të një eksperti kontabël person fizik dhe të ortakëve e shoqërive (firmave) të auditimit vendase dhe të huaja. Këshilli Drejtues realizon kontrollin e cilesise bazuar ne Ligjin e Auditimit, Statutin e IEKAs dhe ne pajtim me kërkesa të tjera të shpjeguara në Standardin Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë 1, dhe ne Standardet Ndërkombëtare të kryerjes se Angazhimeve.

Kontrolli i cilësisë ka për qëllim të verifikojë dhe të japë siguri të mjaftueshme se Eksperti Kontabël i Regjistruar dhe/ose ortaku i angazhimit dhe shoqëria e auditimit respektojnë kërkesat ligjore dhe rregullat e tjera të brendëshme të Institutit dhe se organizimi i firmave të auditimit ju përgjigjet nevojave të ushtrimit të profesionit.

Kontrolli për cilësinë organizohet në mënyrë të atillë që të jetë i pavarur nga ekspertët kontabël të regjistruar apo ortakët e angazhimit dhe shoqëritë e auditimit, të cilat kontrollohen.

## **Neni 2. Detyrimi për kontroll**

Kontrolli i Cilësisë është i detyrueshëm për të gjithë anëtarët të IEKA (persona fizikë, ortakë angazhimi në firmë apo firma (shoqeri) të auditimit).

Anëtarët që refuzojnë t'i nënshtrohen këtij kontrolli bëjnë një shkelje të rregullave të parashikuara në Kodin e Etikës të EKR-ve dhe i nënshtrohen procedurave disiplinore.

Kontrolli i Cilësisë kryhet pranë vendndodhjeve të EKR-ve ose shoqërive të auditimit, që janë subjekte të kontrollit të cilësisë dhe, kur gjykohet e nevojshme nga Komiteti i Cilësisë, edhe në mjediset e IEKA-s. Në të dyja rastet kontrolli për cilësinë shtrihet mbi tërësinë e organizimit dhe të veprimtarisë së ekspertit, ortakut të angazhimit apo të firmes së auditimit si dhe mbi veprimtarinë e cdo eksperti tjetër të angazhuar nga firma e auditimit.

## **Neni 3. Procesi i kontrollit të cilësisë**

Kontrolli i cilësisë realizohet përmes kontrollit të dosjeve të auditimit, rishikimit dhe sigurive të tjera, të përzgjedhura nga ana e Komitetit të Cilësisë dhe përfshin një vlerësim të pajtueshmërisë me standardet e zbatueshme të auditimit, me kërkesat e etikës dhe të pavarësisë, dhe një vlerësim të cilësisë dhe sasisë së burimeve të shpenzuara, të tarifave të auditimit të ngarkuara dhe një vlerësim të sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë të shoqërisë audituese (kabinetit në rastin e personit fizik).

Në përfundim të kontrollit, nga eksperti kontrollues i cilësisë përgatitet një raport, i cili përmban gjetjet faktike dhe konkluzionet kryesore të arritura gjatë kryerjes së kontrollit. Ky raport i paraqitet Komitetit të Cilësisë. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet kontrolluesit dhe të kontrolluarit, arbitrimi bëhet nga Komiteti i Cilësisë, pasi eksperti i kontrolluar ka paraqitur, formalisht, qëndrimet e tij.

Kontrolli i Cilësisë i firmave të auditimit ose EKR-ve persona fizike kryhet si rregull:

- a) Të paktën 1 herë në cdo 4 vjet për EKR-të dhe shoqëritë e auditimit që kanë më shumë se 5 vjet veprimtari në profesion.
- b) Të paktën 1 herë në dy vjet për EKR-të dhe shoqëritë e auditimit që kanë jo më shumë se 5 vjet punë në profesion.

Dosjet e auditimeve ligjore të shoqërive tregtare që zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) i nënshtrohen kontrollit të cilësisë një herë në çdo tre vjet.

## **Neni 4. Ekspertet Kontrollues**

Kontrolli i Cilësisë kryhet nga ekspertet kontrollues, të cilët janë Ekspertë Kontabël të Regjistruar. Përzgjedhja e kontrollorëve për kontrollin e cilësisë bëhet nga komiteti i cilësisë, në bazë të një procedure objektive, e cila jep garanci se nuk ka konflikt interesash ndërmjet kontrollorit dhe ekspertit kontabël ose ortakut, apo shoqërisë audituese që do të kontrollohet.

- Kontrolloret janë EKR me të paktën 3 vjet eksperience;
- Gjate punes se tyre nuk kane marre as nje mase administrative;
- Dallohen per nivelin e tyre profesional, integritet dhe pavaresi.

## **Neni 5.** **Komitetit të Cilësisë**

Për organizimin dhe drejtimin e kontrollit për cilësinë e kryerjes të angazhimeve krijohet Komiteti i Cilësisë, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët tre janë Ekspertë Kontabël të Regjistruar me përvojë dhe emër të mirë, nga të cilët kryetari duhet të jetë anëtar i Këshillit Drejtues të IEKAs, ndërsa dy anëtarët e tjerë duhet të jenë profesionistë të fushës së auditimit dhe mund të vijnë nga bota akademike, ose nga autoritetet mbikëqyrëse të sektorëve të rregulluar të ekonomisë.

Anëtarët e Komitetit të Cilësisë caktohen nga Këshilli Drejtues i Institutit, për një afat 3 vjeçar. Ata mund të ricaktohen, por jo më shumë se edhe një mandat tjetër. Perjashtimisht për mandatin e parë 2 anëtarë, respektivisht një EKR dhe një anëtar që nuk e ushtron profesionin, do të jene për një periudhë 2 vjeçare, me qëllim që të bëhet një ripërtëritje për gjysmën e anëtarëve një herë në dy vjet. Pozicioni i kryetarit dhe zëvendës kryetarit të Këshillit Drejtues wshtw i papajtueshem me funksionin e anëtarit të Komitetit të Cilësisë.

## **Neni 6.** **Detyrat e Komitetit të Cilësisë**

Komiteti i Cilësisë ka këto të drejta e detyra kryesore:

- Harton procedurat që do të zbatohen për të përzgjedhur ekspertët dhe ortakët e angazhimit apo shoqëritë e auditimit që do të nënshtrohen kontrollit të cilësisë, të cilat miratohen nga këshilli drejtues i IEKAs;
- Harton udhëzues pune (manual) për kontrollin, bazuar në udhëzimet e publikuara nga Federata ndërkombetare e Kontablistëve, i cili pasi miratohet nga Këshilli drejtues i bëhet i njohur si eksperteve kontrollues, ashtu edhe eksperteve që kontrollohen;
- Harton programin vjetor të kontrollit të cilësisë, i cili miratohet nga Këshilli Drejtues i IEKAs;
- Harton procedurat e përzgjedhjes së dosjeve që do të kontrollohen. Kontrolli i ushtruar të zere ta pakten 10 % të auditimit të kryer;
- Harton procedurat e përzgjedhjes së ekspertëve kontrollues; të cilat miratohen nga këshilli drejtues i IEKAs;
- Përgatit dhe azhuron tematikën e kontrollit të cilësisë;
- Përcakton periodicitetin e kontrollit si dhe kohën e nevojshme për çdo kontroll;
- Përcakton koston e kontroleve dhe mënyrën e përballimit të koston;
- Njofton ekspertët që do të kontrollohen, ekspertët e tyre kontrollues, si dhe kërkon të dhëna për numrin e misionëve të kryera nga ekspertët apo shoqëritë e auditimit që do të nënshtrohen kontrollit;
- Merr materialet dhe konkluzionet e grupeve të ekspertëve kontrollues dhe bazuar në rezultatet e kontrollit organizon mbrojtjen e materialeve për disa prej ekspertëve të kontrolluar, me pjesëmarrjen e ekspertëve kontrollues, ekspertëve të kontrolluar ose ortakëve të angazhimit apo shoqërive të ekspertëve;
- Përgatit vlerësimet paraprake për përfundimet e rezultateve të kontrollit dhe ia komunikon ato Këshillit Drejtues;
- Harton Modelin e Raportit në lidhje me Kontrollin e cilësisë të kryer së bashku me anekset përkatëse , të cilat i paraqiten për miratim Këshillit Drejtues;
- Harton modelin e Deklaratës së Konfidencialitetit në lidhje me Kontrollin e Cilësisë;
- Organizon trainimin dhe kontrollin epunës së kontrollorëve të EKR-ve, ortakëve apo shoqërive të auditimit;
- Ben propozime dhe rekomandime për masat që duhen marrë ndaj EKR-ve.

## **Neni 7.** **Miratimi i kontrolloreve**

Ekspertët kontrollues miratohen nga Këshilli Drejtues, pas propozimit të Komitetit të Cilësisë. Nuk mund të caktohen ekspert kontrollues anëtarët e Këshillit Drejtues, anëtarët e Komitetit të Cilësisë, anëtarët e Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës,

Anëtarët e Institutit të caktuar me funksionin e ekspertit kontrollues nuk mund të refuzojnë ose të tërhiqen nga kryerja e funksionit përveç se për arsye të pranuar dhe të argumentuara nga Këshilli Drejtues dhe me vendim të tij. Në rast të kundërt konsiderohet se kanë bërë shkelje disiplinore.

Kontrolloret i shërbejnë edhe Bordit të Mbikqyrjes Publike.

## **Neni 8.** **Fillimi i kontrollit**

Brenda datës 15 korrik të çdo viti Komiteti i cilësisë i propozon për miratim KD-së:

- a) Listën e EKR-ve dhe shoqërive të auditimit që do të nënshtrohen kontrollit të cilësisë në përputhje me paragrafin e tretë të nenit 3 të rregullores, duke përfshirë propozimin edhe për listën e mundëshme të auditimeve (dosjeve) për të përzgjedhur të paktën dy prej tyre për kontroll për secilin EKR;
- b) Listën e auditimeve të shoqërive tregtare që zbatojnë SNRF-te, cilat kanë radhën për t'u kontrolluar;
- c) Listën e kontrollorëve ose ekipin e kontrollorëve të cilësisë;
- d) Afatet e kryerjes së kontrollit.

Në përcaktimin e EKR-ve, të dosjeve që do të kontrollohen dhe për përzgjedhjen e dosjeve të auditimeve të pasqyrave financiare të shoqërive tregtare që zbatojnë SNRF-të, Komiteti i Cilësisë bazohet në tabelën e misioneve të auditimit ligjor që i dërgohet Kryetarit të Këshillit Drejtues deri më datën 28 Shkurt të çdo viti.

Në caktimin e ekspertëve kontrollues mbahen parasysh kushtet, njohuritë profesionale specifike, aftësitë për të përmbushur detyrën si dhe pavarësia në raport me ekspertin që do të kontrollohet.

Nuk autorizohet kontrolli reciprok, apo ai midis ortakëve të angazhimit të shoqërisë, si dhe midis atyre që kanë qënë ortakë angazhimi para se të kenë kaluar pesë vjetë nga koha kur individët kanë qënë në këto pozicione.

Nuk autorizohet si kontrollues një ekspert , i cili vete, ose firma e tij i nënshtrohet kontrollit për cilësinë e kryerjes së angazhimeve.

## **Neni 9.** **Afatet**

Kontrolli i cilësisë duhet të kryhet në afatet e përcaktuara në kalendarin e miratuar nga Këshilli Drejtues dhe në pajtim me programin e kontrollit të miratuar nga Komiteti i Cilësisë.

Eksperti ose grupi i ekspertëve kontrollues duhet të përmbushë detyrën e tij në mënyrë të pavarur. Kontrollori do të kryejë verifikimet që i gjykon të nevojshme dhe do të bëjë rekomandimet që i cmon të dobishme. Në rastin e rikontrolleve, do të ndiqen të njëjtat procedura që zbatohen edhe për kontrollin, por në këto raste kontrolli do të kryhet pranë Institutit.

Eksperti ose ekipi i ekspertëve kontrollues ka të drejtën e hyrjes në çdo informacion, që ai e gjykon të nevojshëm për kryerjen e misionit të kontrollit, të përdorë pyetësorë (manuali i kontrollit) dhe të kërkojë sqarime nga eksperti i kontrolluar. Eksperti kontrollues ose ekipi i ekspertëve duhet të vërë në dukje, kur është rasti, se nuk ka pasur të drejtë hyrje në të gjithë informacionin e nevojshëm.

Në përfundim të kontrollit të cilësisë eksperti ose grupi i ekspertëve kontrollues hartojnë një Raport i cili i paraqitet Komitetit të Cilësisë.

Para se të miratojë rezultatet e kontrollit, Komiteti i Cilësisë, bazuar në rezultatet e kontrollit, rishikon dosjet e ekspertëve të kontrolluar dhe të shoqërive të ekspertëve kur kjo gjykohet e nevojshme.

Çdo eksperti të kontrolluar i lind e drejta e ankimit ndaj vendimit të marrë brenda një periudhe 15 ditore pas përfundimit të afatit të kontrollit.

Në të gjithë dokumentacionin e kontrollit të cilësisë të përgatitur nga ekspertet kontrollues do të shënohet adresa e vendit ku është kryer kontrolli i dosjeve.

### **Neni 10.** **Detyrat e kontrolloreve**

Gjatë kontrollit eksperti ose ekipi i ekspertëve kontrollues duhet të shqyrtojnë por pa u kufizuar vetëm në këto, çështjet që kanë të bëjnë:

- me respektimin, gjatë kryerjes së angazhimeve nga ekspertët e kontrolluar, të kërkesave të ligjit, të rregullave për organizimin e profesionit si dhe të standardeve profesionale dhe etike (SNA-tw, SNKC, etj) që janë të zbatueshme për anëtarët e IEKAs;
- me përshtatshmërinë e organizimit të kabinetit apo të shoqërisë së auditimit në varësi të natyrës dhe shtrirjes së veprimtarisë.

Në lidhje me kryerjen e angazhimeve eksperti ose ekipi i ekspertëve kontrollues duhet të verifikojnë, nëpërmjet një seleksionimi të materialeve që përmban një dosje, në se ka koherencë midis dokumenteve të punës të ekspertit që kontrollohet dhe komenteve e përfundimeve ku është bazuar opinioni i dhënë në raportin e tij. Gjithashtu, ata duhet t'i kushtojnë vëmendje sidomos aspekteve të organizimit të angazhimit, ku perfshihet vleresimi i pavaresisë dhe amsave perkatëse mbrojtëse, kur kerkohen te vendosen masa te tilla, përgatitjes e mbajtjes së evidencws sw auditimit nw dosje nga Eksperti Kontabël i Regjistruar, dhe ceshtje te tjera te nevojshme

Në lidhje me organizimin e kabinetit apo të punës në një shoqëri auditimi, eksperti ose ekipi i ekspertëve kontrollues shqyrton strukturën e kabinetit, firmës, formimin e vijueshëm të personelit dhe të anëtarëve të tjerë të të firmës së auditimit, sistemet dhe procedurat e përdorura, si edhe faktin nëse firma/kabineti ka vendosur një kontroll cilësie të brendshëm. Eksperti ose ekipi i ekspertëve kontrollues duhet të mbledhë informacion mbi respektimin e rregullave dhe të normave të etikës profesionale dhe vecanërisht për sa i përket papajtueshmërisë me standardet profesionale dhe me kërkesat e pavarësisë.

Të dhënat financiare të brendshme të kabinetit apo të shoqërisë nuk përbëjnë në vetvete objekt të këtij kontrolli. Megjithatë eksperti ose ekipi i ekspertëve kontrollues mund të ketë të drejtë të hyjnë në informacionin financiar për të verifikuar që honoraret dhe normimi i oreve të punës u përgjigjen shërbimeve të kryera dhe që burimet njerëzore dhe materiale ju përgjigjen shtrirjes dhe natyrës së misionëve dhe janë vënë efektivisht në shërbim të këtyre misionëve.

## **Neni 11. Raportimi**

Raporti i ekspertit apo i ekipit të ekspertëve kontrollues duhet të përmbajë të paktën informacionet për këto çështje:

- a) mënyrën se si është kryer kontrolli;
- b) një përshkrimin dhe vlerësim të përgjithshëm të strukturës së EKR ose shoqërisë, si dhe cdo informacion tjetër lidhur me organizimin e kabinetit ose të shoqërisë së auditimit, i cili lidhet me nevojën për të vlerësuar ndërtimin dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm të cilësisë,
- c) një përshkrim të mënyrës së mbajtjes së dosjeve dhe një vlerësim të cilësisë së raporteve të angazhimit të lëshuara nga EKR apo ortaku i angazhimit, apo shoqëria e auditimit;
- d) shkeljet e ligjit, të rregullave dhe të standardeve të profesionit që janë konstatuar nga kontrolli;
- e) dobësitë dhe neglizhencat e konstatuara;
- f) një vlerësim për karakterin e përshtatshëm ose jo të burimeve njerëzore e materiale, të para këto në lidhje me natyrën dhe shtrirjen e angazhimeve ligjore e statutore, përdorimin e tyre efektiv për këto angazhime si dhe dhënia e opinionit në se honoraret dhe pagesat iu përgjigjen ose jo shërbimeve të kryera;
- g) rekomandimet për ekspertin e kontrolluar dhe për Institutin, për veprimet që priten të ndërmerren nga ky i fundit në lidhje me rekomandimet e dhëna.

Dorëzimi i Raportit të grupeve kontrolluese bëhet sipas hapave të mëposhtëme:

- Një kopje të raportit të kontrollit (në formë e tij paraprake) Ekspertët kontrollues ja dorëzojnë ekspertit të kontrolluar ose ortakut të angazhimit apo shoqërisë së ekspertëve që është kontrolluar
- Eksperti i kontrolluar ose ortaku apo shoqëria e auditimit e studiojnë raportin paraprak dhe diskutojnë për çështjet e raportit me ekspertin kontrollues
- Eksperti kontrollues përgatit raportin final, ku nënshkruajnë si eksperti kontrollues ashtu edhe ai i kontrolluar . Ky raport i dërgohet Komitetit të Cilësisë, i shoqëruar me dokumentacionin që përshkruhet në udhëzimin për zbatimin e kontrollit të cilësisë.
- Në rastet kur ka mosmarrëveshje midis të kontrolluarit dhe kontrolluesit, Komiteti i cilësisë organizon një seance ku palët thirren të japin shpjegimet nevojshme në lidhje me kundërshtitë e tyre. Pasi dëgjon palët, komiteti merr vendimin përkatës.

## **Neni 12. Vlerësimi**

Ekspertet kontrollues do të vlerësojnë EKR-të dhe shoqëritë e auditimit, si edhe dosjet e auditimeve të pasqyrave financiare të shoqërive që zbatojnë SNRF-të, duke përdorur për këtë qëllim Manualin e kontrollit të cilësisë të miratuar nga BMP për entitetet me interes publik.

Shkallët e vlerësimit që do të përdoren nga kontrollorët e cilësisë janë:

- ✓ Shumë Mirë,
- ✓ Mirë,
- ✓ Mjaftueshëm,
- ✓ Jomjaftueshëm

Komiteti i kontrollit të cilësisë do të përgatisë vlerësimin përfundimtar të EKR-ve dhe shoqërive të auditimit që kontrollohen bazuar në Vlerësimet e Ekspertëve kontrollues.

Këshilli i Drejtimit miraton vlerësimet përfundimtare të paraqitura nga Komiteti i Kontrollit të Cilësisë për EKR-të dhe shoqëritë e auditimit të kontrolluara.

### **Neni 13. Sekreti Profesional**

Kontrolli i Cilësisë të kryerjes të angazhimeve kërkon respektimin strikt të sekretit profesional si nga ana e ekspertit kontrollues ashtu edhe nga ai i kontrolluar.

Bërja e ditur të tretëve, direkt ose indirekt të faktit që kabineti apo shoqëria i është nështruar detyrimit të kontrollit dhe/ose të raportit të përgatitur e të përfunduar të kontrollit përbën një shkelje të rregullave të etikës profesionale dhe ndëshkohet nga procedurat disiplinore.

Eksperti kontrollues ose ekipi i ekspertëve kontrollues që ka kryer një kontroll duhet t'i dorëzojë Komitetit të Cilësisë të gjitha dokumentet lidhur me kontrollin.

Raportet e kontrollit dhe cdo dokument tjetër që lidhet me kontrollet janë dokumenta të brendshëm të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe përmbajtja e tyre nuk mund të përhapet tek të tretët.

Rezultatet e përgjithshme të sistemit të kontrollit të cilësisë publikohen çdo vit nga IEKA, në mënyrë të përmbledhur dhe pa përmendur emrat e vecantë.

Rekomandimet e Komitetit të Cilësisë duhet të ndiqen për t'u zbatuar nga eksperti kontabël ose shoqëria e auditimit brenda një periudhe kohe të arsyeshme.

### **Neni 14. Mbikëqyrja**

Sistemi i kontrollit të cilësisë i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, i cili shqyrton dhe vlerëson programet dhe raportet e Komitetit të Cilësisë, dhe monitoron kryerjen e procedurave të kontrollit të cilësisë

Raportet e Komitetit të Kontrollit të cilësisë të miratuara nga Këshilli Drejtues i paraqiten për shqyrtim Bordi i Mbikëqyrjes Publike.<sup>i</sup>

---

<sup>i</sup> Miratuar me vendimin nr.15 date 30.05.2011 dhe ndryshuar me vendimin nr 8 date 16.07.2013 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike